

	PERGATITJA E PACIENTIT/ES PER KOLONOSKOPI	Ver.	Rev.	03
		01	Data	22.11.2021
UNI - EN - ISO 9001:2015			Faqja 1 nga 1	

Pacienti/ja duhet të marrë në farmaci Sulfat Magnezi (3 Paketa nga 30 gr secila), të cilat do të përdoren duke ndjekur hap pas hapi udhëzimet e mëposhtme:

2(DY) DITË PARA EKZAMINIMIT:

1. Vakti i fundit i ushqimit të pacientit/es do të jetë në orën 20:00, 2(dy) ditë përpara ekzaminimit.

1(NJË) DITË PARA EKZAMINIMIT:

1. Në orën 08:00, një ditë para ekzaminimit, do të tresë 1(një) paketë e gjysëm nga doza e Sulfatit të Magnezit në gjysëm gote ujë të ftohtë dhe do ta pijë.
2. 30 (tridhjetë) minuta pasi e ka pirë dozën, do të pijë 1(një) gotë ujë natyral të ftohtë.
3. **Gjatë orëve të ardhshme pacienti/ja duhet të konsumojë të paktën 3 (tre) litra lëngje.**
4. Në orën 19:00, do të tresë 1 paketë e gjysëm (sasia e mbetur nga doza e mëparshme e Sulfatit të Magnezit) në gjysëm gote ujë të ftohtë dhe do ta pijë.
5. 30 (tridhjetë) minuta pasi e ka pirë dozën, do të pijë 1(një) gotë ujë natyral të ftohtë.
6. **Gjatë orëve të ardhshme pacienti/ja duhet të konsumojë të paktën 3 (tre) litra lëngje.**

DITA E EKZAMINIMIT:

1. Ditën e ekzaminimit nuk duhet të konsumojë më asgjë dhe duhet të paraqitet në orarin e caktuar në klinikë.

KUJDES!!!

- Lëngjet duhet të jenë të pastra, të kulluara (bujon) dhe **JO ME NGJYRË TË KUQE**. Kryesisht lëng mishi i pastër (duhet të konsumohet patjetër) dhe lëngje të tjera të tejudkshme, si çaji dhe uji.
- Pacientët që janë nën mjekim me hollues gjaku si Aspirina, Sintromi, Warfarina, Xarelto, etj. **DUHET TI NDËRPRESIN** ato 2 (dy) deri në 5 (pesë) ditë para ekzaminimit, në varësi të holluesit që marrin. **KUJDES!!! Përpara se pacientët ta ndërpresin atë, duhet të konsultohen me mjekun që ka rekomanduar mjekimin me hollues.** Në disa raste, mjeku përkatës mund të rekomandojë aplikimin e Clexan-it (Enoxaparinës) nën lëkurë, gjatë periudhës së ndërprerjes së holluesve. Pas kryerjes së Kolonoskopisë, holluesit do të fillohen përsëri.
- Pacientët që vuajnë nga diabeti dhe marrin mjekime për të, **DUHET TË PËRGJYSMOJNË DOZËN** ditën e ekzaminimit.
- Pacientët që vuajnë nga tensioni dhe marrin mjekime për të, **NUK DUHET TI NDËRPRESIN** ato.
- Pacienti duhet të vijë i shoqëruar nga 1 (një) person tjetër (familjar ose i afërm) ditën e ekzaminimit.
- **Nëse nuk zbatohet procedura përgatitore e mësipërme, në çdo pikë të saj, ekzaminimi nuk mund të kryhet.**

Për të kryer këtë ekzaminim në Klinikën Kajo, ju duhet të rezervoni paraprakisht orarin pranë recepsionit ose në numrat e mëposhtëm:

Cel: +355 (0) 68 200 30 77 / +355 (0) 67 200 30 77

E Hënë – E Premte, 09:00 – 19:00